



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3101/ 18 prot.

Datë 19.12.2025

V E N D I M
Nr. 1888/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.12.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit nr. 1728/2025, datë 20.11.2025 dhe nr. 1774/2025 datë 03.12.2025 të KPP-së për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-60070-09-02-2025, me objekt: “Sherbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e SHRUKD sh.a”, me fond limit 25,097,400.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.A

Ankimues:

Operatori ekonomik “Adel Co” SHPK me NIPT L22117021M dhe adresë: Rr.Efendiu Nr.13,Tirane 1050, Tiranë

Operatori ekonomik “Inpress” SHPK me NIPT L52122014L dhe adresë: Rruga “Siri Kodra” ish-blloku i magazinave tregtare-Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.A me adresë: “L.17 Rr. Dalip Peza, Durrës

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik “Inpress” SHPK me NIPT L52122014L dhe adresë: Tiranë, Ish Blloku i Magazinave të Tregtisë, Rruga Siri Kodra

Operatori ekonomik “Adel Co” SHPK me NIPT L22117021M dhe adresë: Rr.Efendiu Nr.13,Tirane 1050, Tiranë

Operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK me NIPT
L51819005Q dhe adresë: Tiranë, Kashar, Rruga Çerçiz
Topulli Nr.17 - 1051

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar,
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021
“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i
ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.
766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave
“Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të
Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të
Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020
“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për
Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të
Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së
shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në
tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 03.12.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 17274/2025 ku
vendosi:

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr.REF-60070-09-02-2025, me objekt: “Sherbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e SHRUKD sh.a”, me fond limit 25,097,400.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës Sh.A.
 2. Autoriteti kontraktor të dërgojë në KPP dokumentet e reja të procedurës së prokurimit të modifikuara sipas konstatimeve të vendimit nr.1728/2025, datë 20.11.2025.
 3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 2285/48 prot., datë 16.12.2025 protokolluar me tonën nr. 3101/15 prot., datë 18.12.2025 autoriteti kontraktor njofton se e ka zbatuar vendimin e KPP-së me nr. 1774/2025, datë 03.12.2025, duke i bashkëngjitur shkresës modifikimin e dokumenteve të tenderit.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 2285/48 prot., datë 16.12.2025 protokolluar me tonën me nr. 3101/15 prot., datë 18.12.2025 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së me nr. 1774/2025, datë 03.12.2025, duke i bashkëngjitur shkresës modifikimin e dokumenteve të tenderit.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit si dhe shkresa për modifikimin e dokumenteve të tenderit është përputhje me konstatimet e KPP-së të shprehura në vendimet e sipërcituara.

II.3. Sa më lart, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimet e KPP nr. 1728/2025, datë 20.11.2025 dhe nr. 1774/2025 datë 03.12.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-60070-09-02-2025, me objekt: “Sherbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e SHRUKD sh.a”, me fond limit 25,097,400.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr.REF-60070-09-02-2025, me objekt: “Sherbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e SHRUKD sh.a”, me fond limit 25,097,400.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

